

Kosovo News 2

Prill 2003

Në këtë numër:

- **Informata me rëndësi për punëkërkuessit**
- **“Kosova ka tatimet mbi fitim më të ulëta në regjion.”**
Intervist me Ahmet Shala, KTA

Informata me rëndësi për punëkërkuessit

Masat përkrahëse për të kthyerit në Kosovë si dhe bursa e vendeve të punës, si elemente përkrahës gjatë reintegrimit në tregun e punës do të vazhdojnë edhe në vitin 2003.

Para kthimit në Kosovë, refugjatët duhet të konkurojnë për një vend pune ose për një kualifikim profesional në zyrën e AGEF-it në Berlin dhe pas kthimit të tyre në Kosovë të kontaktojnë zyrën së AGEF-it në Prishtinë.

Masat përkrahëse realizohen në Kosovë dhe janë të orientuara në

- Pagesa e një shtesës në rrogë për punëmarrësin me një afat deri maksimal 6 muaj, ose
- Përkrahja për fillimin e një kualifikimi profesional
- Pjesëmarrja në një seminar mbi themelimin e afarizmit privat, dhe eventualisht përkrahja për themelimin e ndërmarrjes.

Masat përkrahëse financohen nga Ministria Federale për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) nëpërmjet Qendrës për Ndërmjetësim Pune (ZAV) dhe nga mjetët e Fondit Evropian për Refugjatët nëpërmjet Entit Federal për Migrim dhe Refugjatë (BAMF), dhe realizohen nga AGEF-i.

Për informata të tjera dhe për konkurim ju lutemi drejtohuni AGEF Berlin ose AGEF Prishtina (adresat shih në faqën e dytë).

„Kosova ka tatimet mbi fitim më të ulta në regjion“

Intervista me z. Ahmet Shala, drejtorin e Agjencionit të Mirëbesimit të Kosovës (KosovoTrust Agency KTA), fund i marsit 2003 në Prishtinë

Si është situata ekonomike në Kosovë?

Duke pas parasysh të kaluarën e Kosovës gjindemi në një situatë të rëndë ekonomike. Në ish-Jugosllavinë Kosova ka pas një pozitë koloniale, ku struktura ekonomike si e tillë ka qenë e trashëguar, dhe duke pas parasysh se çka ka ndodhë gjatë viteve të 90, kjo periudhë e ka rënduar edhe më

tepër situatën ekonomike. Ndërmarrjet shoqërore patën një menaxhim më tepër hutues, edhe ajo çka ka mundur të ndërtohet gjatë 50 viteve është shkatërru. Sidomos gjatë luftës ekonomia e Kosovës pësoi shkatërrimet më të rënda. Pas luftës ka pas përpjekje për tejkalimin e kësaj situatë, mirëpo për shkaqe të pengesave juridike dhe politike shumë aktivitete janë vonuar, dhe kjo ka ndikuar në ngadalësimin e procesit të privatizimit.

Jeni në procesin privatizimit, deri ku keni arritur me përgatitjet rreth procesit?

Pas luftës përpjekjet e të gjithë ekspertëve vendorë dhe miqëve ndërkombëtarë ishin që procesi i privatizimit të fillojë menjëherë. Por ishin hezitime dhe pengesa të ndryshme politike me komentime juridike se Kosova nuk mund të bëjë atë. Deri sot e kësaj dite, edhe pse kemi përparuar shumë në këtë drejtim, mendoj se nuk janë tejkaluar të gjitha ato pengesa. Procesi i privatizimit tanimë ka filluar dhe shpallja e tenderëve dhe thirrja e investitorëve për të konkuruar do të bëhet merenda pak ditëve.



Procesi i privatizimi do të sjellë me vete për një afat të shkurtër edhe rritjen e papunësisë, ku një grup i të punësuarëve do të humbin vendin e tyre të punës si rezultat i këtij procesi. A ekzistojnë projekte dhe mundësi të financimi të tyre, me qëllim të reintegrimit të këtij grupi në tregun e punës?

Ato vende të punës janë edhe ashtu të vdekura. Ekziston vetëm një bindje fiktive se njerëzit po punojnë, ku në realitet shumica e tyre janë vetëm në listat e punëtorëve. Pa marrë parasysh formën e aktivizimit të ndërmarrjeve të cilat do të privatizohen, minimumi do të mbajë numrin punëtorëve, sa edhe tani janë duke shkuar në punë. Normalisht se nuk do të mbajë të njëjtit punëtorë, se do të kërkohet një forcë e re me karakteristika tjera të aftësive punuese. Në këtë drejtim mund të them se do të ndërrohet struktura e punës dhe ata të cilat ndoshta janë duke pritur për të punuar diçka do ta humbin vendin e punës. Ne kemi menduar një numër masash, jo social por nxitës, të cilat do ta përkrahin procesin e privatizimit dhe në një formë do ta shuajnë një “shok” social i cili mund të pritët. Natyrisht se Qeveria e Kosovës bashkë me donatorët e jashtëm dhe institucionet tjera ndërkombëtare do të gjejnë format të cilat do të zbusin problemet sociale. Neve kemi menduar

që 20% të vlerës mbi çmimin do t'u ndahet punëtorëve linëarisht dhe në bazë të kohëzgjatjës të punësimit pranë asaj ndërmarrjeje.

Me bashkimin e të dy Gjermanive, edhe Gjermania lindore kaloi fazën e transferimit dhe ju nënshtriu procesit të privatizimit. Sa keni bashkëpunim me ndonjë institucion përkatës në Gjermani, të cilat kanë përgatitë modele dhe kanë bërë implementimin e tyre?

Shumica e staf-it në udhëheqjen e Agjencionit të Mirëbesimit të Kosovës janë gjermanë. Ndoshta kjo është për shkak se ata kanë pas eksperiencë të madhe. Por kjo nuk do të thotë se do të zbatohet gjithçka çka është bërë në Gjermani për hirë të specifikave që ka Kosova. Mendoj se shumë përvoja pozitive do të barten nga Gjermania. Ndërsa kooperimi më i mirë do të jetë me institucionet e biznesit gjerman dhe do të bëjmë çmos që ato të inkurajojmë dhe të vijnë të investojnë në Kosovë. Kjo është bashkëpunimi dhe mënyra më e mirë që përvojat gjermane të bartim në Kosovë, jo vetëm menyrën e privatizimit por edhe mënyrën e filozofisë së punës, çasjes ndaj tregjeve të reja etj.

Ju përmendët inkurajimin e investitorëve të huaj. Çka i ofron Kosova investitorëve të huaj dhe pse ata duhet të investojnë këtu?

Kosova nuk është treg vetëm i 2 milion banorëve. Sipas hulumtimeve që ne kemi bërë Kosova është treg i më se 20 milion banorëve, duke marrë parasysh shkatërrimet që janë bërë. Është shkaktuar një mungesë e përkohëshme e shumë gjërave, duke filluar nga gjërat elementare e deri tek maqineritë e ndryshme. Kosova ka një potencial të shkëlqyer të rinisë e cila është e motivuar për punë. Si treg egziston si qendër e Ballkanit, ka 300 km afër Beogradin, 300 km Podgoricën, 300 km ka dy detet, Detin e Zi dhe Detin Egje dhe Detin Adriatik. Por avantazhi më i mirë është motivimi i rinisë kosovare për të punuarë. Rinia është mjaft fleksibile, ka njohuri të mira të gjuhëve të huaja dhe njohuri kompjuterike.

Sa i përket çmimit të punëtorëve nuk mund të them se është i lirë, është mesatar. Çmimi i pagës në Kosovë është momentalisht artificial për hir të prezencës së madhe ndërkombëtare, por paga mesatare është më e lartë se sa në regjion.

A do të kenë përparësi investitorët e huaj në krahasim me ata të vendit? Cilat janë kushtet për pjesëmarrje në tender?

Duke marrë parasysh përvojat e shteteve tjera mendoj se në të dy rastet, d.th. në rastin e parë kur ju është ofru përparësi të huajve në krahasim me vendorët është bërë gabim, si dhe në rastin tjetër. Që të dy praktikët kanë treguar se janë jo të mira. Ne kemi gjetë një model ku të dy palët janë të barabartë. Në kuptimin e përparësive për investime në Kosova, Kosova ka ligjet mbi taksat më

të avansura në regjion. Taksat mbi profitin janë më të ulta në regjion dhe kjo mendojmë që do të jetë faktor i rëndësishëm për inkurajimin e investitorëve të huajë.

Si e vlerësoni rolin e AGEF-it në Kosovë?

AGEF-i ka bërë një punë shumë të madhe, çoftë në përpjekjet në krijimin e vendëve të punës për ata që kthehen ose për të nxitur investimet gjermane këtu në Kosovë. Besoj se në të ardhmën AGEF dhe institucionet tjera që kanë të bëjnë me Gjermaninë do të jenë më aktive. Ne do të bëjmë çmos që gjatë promovimit të investimeve të lidhim jo vetëm AGEF-in por edhe institucionet tjera të cilat mundën ta ndihmojnë sqarimin e të gjithë procesit të privatizimit si dhe inkurajimin e investitorëve të mundëshëm në Kosovë.

Si do të jetë e ardhmja ekonomike e Kosovës?

Çdo hap drejt privatizimit është një hap para. Çdo hap drejt rritjes së efikasitetit të një ndërmarrjeje, të cilat tani janë të “vdekura” ose të “paralizuara” është një hap përpara. Unë jam optimist në rininë e Kosovës, në të ardhmën e ekonomisë së Kosovës. Ne kemi pas tragjedi gjatë historisë dhe viteve të 90, por në atë tragjedi ka pas një fat që kosovarët janë përgatitë për ekonominë e tregut, pasi që ka mbizotëru ligji “te jeshë apo të mos jeshë”. Prandaj edhe ekonomia e tregut është një formë “te jeshë apo të mos jeshë”. Jam i sigurt se kosovarët dinë ta menaxhojnë të ardhmën e vet, nëse disa nga pengesat juridike dhe politike do të mënjanohen.

Intervist: © D.E.



Arianiti (21) dhe Gëzimi (20) absolvojnë tani një praktikë tremujore pranë firmës „Lindi Pharm“ në Gjilan, praktikë kjo si parapërgatitje për studimet në lëmin e farmacisë si dhe përshtypje e parë e profesionit të mëvonëshëm.

Arbeitsgruppe Entwicklung und Fachkräfte im Bereich der Migration und der Entwicklungszusammenarbeit
AGEF gGmbH
PF 660 123, D - 10267 Berlin, tel.: 030-501085-0, faks: 030-5097804, e-mail: info@agef.de

AGEF Pristina

Konstantini i Madh 3, KOS - 38000 Pristina, tel. +381-(0)38-243474, faks: +381-(0)38-243475
e-mail: agef_pr@ipko.org

Internet:
www.agef.net
www.agef.de

AGEF
gemeinnützige Gesellschaft mbH